



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 21.09.2016	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-274

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

DHE

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në vijim si UPz, adresa "Rruga e Shkronjave" nr 1, 20000 Prizren, e përfaqësuar nga Rektori **Prof. Dr. Ramë Vataj**

dhe

Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në vijim UKZ, adresa "Zijah Shemsiu" p.n. 60000 Gjilan, e përfaqësuar nga Rektori **Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi**

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (Më poshtë "Marrëveshja"), është zhvillimi i bashkëpunimit akademik në nivelin e studimeve universitare, si dhe zhvillimi i aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe kulturore ndërmjet dy Universiteteve.

Neni 2

Bashkëpunimi do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë dhe lirinë akademike të të dyja palëve. Palët zotohen që të marrin në shqyrtim nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre me qëllim për të përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi shkencor, edukativ dhe kulturor.

Neni 3

Bashkëpunimet e mbështetura në këtë Marrëveshje do të përcaktohen në detaje në protokolle të veçanta të cilat do të firmosen, pasi njësitë brenda universiteteve të kenë përcaktuar detajet e marrëveshjeve në praktikë dhe më pas do të firmosen nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë.

Protokolli do të përcaktojë subjektet dhe pjesëmarrësit e bashkëpunimit, kuotat e shkëmbimit dhe detajet e tjera të rëndësishme. Protokolli do të jetë pjesë integrale e kësaj Marrëveshje.

Neni 4

Palët mundën të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme në fushat akademike me interes të përbashkët:

- a) Hartimin dhe Implementimin e programeve të përbashkëta studimore, veçanërisht për programe Master dhe Doktoratë;
- b) Shkëmbim të personelit akademik sipas nevojave të të dy universiteteve, ku stafi i rregullt akademik i të dy universiteteve do të angazhohet në bazë të kësaj Marrëveshje duke mos iu nënshtruar procedurave të konkursit publik;
- c) Shkëmbim studentësh të cikleve të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave dhe anasjelltas;
- d) Aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor; pjesëmarrje në seminare, konferenca, evenimente dhe takime tjera akademike;
- e) Shkëmbim të materialeve akademike si dhe informacione të tjera të nevojshme, programe të veçanta akademike afatshkurtra, etj..

Neni 5

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e firmosjes nga përfaqësuesit e secilit universitet.

Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, që nga data e nënshkrimit nga të dyja palët, me mirëkuptim që të mund të përfundojë edhe përpara këtij afati, me iniciativën e njëjës prej palëve, duke njoftuar 12 (dymbëdhjetë) muaj më parë.

Neni 6

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet dhe/ose plotësohet në pjesë të veçanta të saj, nëse të dy palët bien dakord me shkrim. Ndryshimet dhe/ose plotësimet do të bëhen në formën e anekseve të kësaj Marrëveshje dhe do të firmosen nga personat e autorizuar të të dyja palëve.

Neni 7

Të dyja Universitetet i përmbahen politikave të mundësive të barabarta dhe nuk diskriminojnë mbi baza racore, të ngjyrës, moshës, etnive, fetare, paaftësive, origjinës kombëtare apo orientimeve seksuale. UKZ dhe UPz do të udhëhiqen nga këto parime në administrimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 8

Marrëveshja aktuale është e nënshkruar në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe, dy nga të cilat janë të UKZ-së dhe dy të tjera të UPz-së. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën fuqi ligjore dhe janë njësoj të vlefshme për të dyja palët.

Për Universitetin
"Ukshin Hoti"

Prof. Dr. Ramë Vataj, Rektor



Për Universitetin
"Kadri Zeka"

Prof. Asoc. Dr Bajram Kosumi, Rektor


